Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

e) Nga punonjësit e kërkuar më sipër, minimalisht punonjësit e kualifikuar si:

- Ing Elektrik 1 (një)
- Ing Ndërtimi 1 (një)
- Elektricistë 4 (katër)

duhet të jenë të pajisur me OMVK në përputhje me kërkesat ose standardet ekuivalente sipas Rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike. Për këtë operatorët ekonomikë krahas dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.3 /b/, duhet të paraqesin edhe dëshminë përkatëse që vërteton kualifikimin OMVK.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

f) *Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë, për periudhën tre muajt e fundit nga shpallja e tenderit. Përjashtim nga kjo bëjnë punonjësit e kualifikuar si (Automakinist), të kërkuar sipas gërmës “d”, të cilët përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jenë të kontraktuar vetëm në rastet kur mjetet/makineritë dispononohen me qera.*

Ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, dokumentacionin si më poshtë:

- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e tre muajve të fundit nga shpallja e tenderit.

Argumentimi (2.3.3. a dhe b)

Kërkesat e shkronjave a) dhe b), të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe nevojave për realizimin e punimeve.

Konkretisht DTL/OSSH ka ne zotërimin e vet rreth 1300 km linja TL pjesa me e madhe e te cilave është ajrore, dhe ne terrene te vështira, malore etj prandaj numri i punonjësve

është kërkuar në mënyrë që punimet të kryhen sa më shpejt të jete e mundur, për të siguruar furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve që ato furnizojnë.

Numri i inxhinierëve, specialistëve dhe punonjësve sipas profesioneve përkatëse, është kërkuar duke parë klasifikimin e rëndësisë së veçantë që kanë linjat TL të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Numri i tyre në punimet e shërbimit, mirëmbajtje, riparimit të shtyllave TL është bazuar në zërat dhe volumet e parashikuar në punimet e preventivit, për arsye të mëposhtme:

- Punimet civile duhet të kryhen sa më shpejt, dhe me kujdesin maksimal duke zbatuar rregullat e sigurimit teknik sepse janë punime në linja TL, në lartësi dhe shkallën e rrezikshmërisë së jetës e kanë të lartë.
 - Numri i mjaftueshëm por i nevojshëm i punonjësve të mësipërm, është menduar edhe për arsye sigurie, duke qenë punime me ritme të shpejta dhe orar të zgjatur në mënyrë që punonjësit të mos jene të tejlodhur nga puna, dhe nga vështirësitë fizike.
- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve objekt kontrate për të gjithë zërat e punimeve ndërtimore, sipas parashikimeve në projektet përkatëse që do të hartohen rast pas rasti.
 - **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në projektet përkatëse që do të hartohen rast pas rasti..
 - **Elektrici** është i nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
 - Montator (Të certifikuar për punime në lartësi) është i nevojshëm për montimin e elementeve perberese të shtyllave dhe linja elektrike në lartësi në përputhje me rregulloren e sigurimit teknik.
 - **Saldator dhe prerës të metaleve** janë të nevojshëm për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.

Argumentimi (2.3.3 c)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Argumentimi (2.3.3. d)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “*Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre*”, miratuar me urdhrin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Automakinistët kërkohen në funksion të përdorimit të mjeteve eskavator dhe autovinç.

Argumentimi (2.3.3. e)

Kërkesa që punonjësit e kualifikuar të jenë të pajisur me **OMVK** është vendosur në përputhje me **Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike**. Kjo pajisje garanton se personeli teknik ka njohuritë dhe certifikimin e nevojshëm për kryerjen e punimeve elektrike në kushte sigurie, duke parandaluar rreziqet teknike dhe aksidentet në punë. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit dhe është proporcionale, duke lejuar edhe standarde ekuivalente.

Kërkesa për inxhinierët e sipërcituar është në përpjestim dhe e lidhur me objektin e kontratës, respekton edhe parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë minimale e mundur të plotësohet nga çdo OE që ka në objektin e vet tregëtar keto lloj niveli punimesh. Keto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6, të Nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe Nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

Në lidhje me kërkesën për inxhinieret e kërkuar, është vendosur duke marrë në konsideratë volumin e punimeve objekt kontrate dhe për ti dhënë siguri Autoritetit Kontraktor që OE fitues do të arrijë të realizojë punimet e kërkuara. Numri i personelit kryesor i nevojshëm për këtë kategori është minimal dhe nuk kufizon konkurrencën. Këto kërkesa për kualifikim janë në përputhje me pikën 6/c të nenit 39, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, si dhe me Nenin 77 të të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Inxhinier Elektrik – 1 (një)

Angazhimi i **1 (një) Inxhinieri Elektrik** është i domosdoshëm për garantimin e projektimit, koordinimit teknik dhe mbikëqyrjes profesionale të punimeve elektrike që parashikohen në objektin e kontratës. Kjo kërkesë argumentohet teknikisht si më poshtë:

- **Mbikëqyrjen dhe drejtimin teknik të punimeve elektrike**, duke siguruar që zbatimi të kryhet në përputhje të plotë me projektet e miratuara, specifikimet teknike dhe standardet përkatëse.
- **Analizën dhe zgjidhjen e problematikave komplekse teknike**, që mund të lindin gjatë fazës së instalimit, testimit dhe vënies në punë të sistemeve elektrike.

- **Koordinimin ndërmjet disiplinave teknike**, veçanërisht ndërthurjen e punimeve elektrike me ato ndërtimore dhe teknologjike, për të shmangur konfliktet teknike gjatë zbatimit.
- **Verifikimin dhe miratimin e materialeve, pajisjeve dhe skemave elektrike**, duke garantuar përputhshmëri me kërkesat teknike, normat e sigurisë dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.
- **Përgjegjësinë profesionale për dokumentacionin teknik**, përfshirë aktet e kolaudimit, raportet e testimit, situacionet dhe dokumentacionin përfundimtar të dorëzimit të punimeve.

Kërkesa për **1 (një) Inxhinier Elektrik** është e justifikuar nga kompleksiteti teknik i punimeve, është proporcionale me objektin e kontratës dhe nuk përbën kriter kufizues për konkurrencën, duke garantuar cilësi, siguri dhe realizim të suksesshëm të kontratës.

-Për sa i takon inxhinierit mekanik të kërkuar, është e nevojshëm për zbatimin e kontratës pasi inxhinieri mekanik do të ndjekin ecurinë e punimeve mekanike si montime dhe demontime të pajisjeve dhe konstruksioneve mekanike të investimit në rastin konkret sic janë shtyllat e kesaj linje si pjesë e këtij e projekti te shprehura ne preventivin perkates.

Inxhinier Ndërtimi – 1 (një)

Angazhimi i **1 (një) Inxhinieri Ndërtimi** është i domosdoshëm për planifikimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen profesionale të punimeve ndërtimore dhe civile që parashikohen në objektin e kontratës. Kjo kërkesë argumentohet teknikisht si më poshtë:

- **Mbikëqyrjen dhe drejtimin teknik të punimeve ndërtimore**, duke garantuar zbatimin korrekt të projekteve të miratuara, detajeve të zbatimit dhe specifikimeve teknike përkatëse.
- **Koordinimin e punimeve ndërtimore me punimet elektrike dhe teknologjike**, me qëllim shmangien e konflikteve teknike dhe sigurimin e një ecurie të pandërprerë të punimeve në terren.
- **Vlerësimin e kushteve ekzistuese në objekt**, përfshirë strukturat, bazamentet, kanalet, themelet dhe elementët mbajtës, për të garantuar siguri strukturore gjatë ndërhyrjeve.
- **Kontrollin e cilësisë së materialeve dhe punimeve ndërtimore**, duke siguruar përputhshmëri me standardet teknike, normat e ndërtimit dhe kërkesat ligjore në fuqi.
- **Hartimin dhe verifikimin e dokumentacionit teknik**, përfshirë situacionet e punimeve, aktet e kolaudimit dhe dokumentacionin përfundimtar të dorëzimit të objektit.

Kërkesa për **1 (një) Inxhinier Ndërtimi** është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve ndërtimore të parashikuara, nuk përbën kriter diskriminues dhe garanton realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat teknike, ligjore dhe standardet e sigurisë.

Elektracistë – 4 (katër)

Angazhimi i **4 (katër) Elektracistëve** është i nevojshëm për realizimin e punimeve elektrike në mënyrë të sigurt, cilësore dhe brenda afateve të përcaktuara në objektin e kontratës. Kjo kërkesë argumentohet teknikisht si më poshtë:

- **Volumi i konsiderueshëm i punimeve elektrike**, që përfshin shtrirjen e kabllimeve, montimin e pajisjeve elektrike, lidhjet funksionale, tokëzimet dhe ndërhyrjet ndihmëse, kërkon një numër të mjaftueshëm punonjësish për zbatim paralel.
- **Punë në disa pika dhe fronte pune njëkohësisht**, çka e bën të domosdoshëm angazhimin e disa elektracistëve për të garantuar respektimin e afateve kontraktuale dhe planifikimin eficient të punimeve.
- **Sigurimin e cilësisë së zbatimit**, pasi ndarja e detyrave ndërmjet elektrikistëve (montim, lidhje, verifikim) redukton gabimet teknike dhe rrit saktësinë e instalimeve.
- **Respektimin e standardeve të sigurisë elektrike dhe në punë**, veçanërisht gjatë punës në ambiente me rrezik elektrik, ku prania e disa punonjësve rrit sigurinë dhe mundëson asistencë të menjëhershme në rast nevojë.
- **Mbështetjen e punës së teknikëve dhe inxhinierëve elektrikë**, duke siguruar zbatim korrekt të udhëzimeve teknike dhe të projekteve të miratuara.

Kërkesa për **4 (katër) Elektricitetë** është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara, nuk krijon barriera të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe garanton realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat teknike, ligjore dhe standardet e sigurisë.

AK argumenton se kërkesa për inxhinieret është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Argumentimi (2.3.3. f)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/ç), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore si pjesë të përvojës së shoqërisë, përvojë kjo e nevojshme për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimit, pasi fakti që shoqëria disponon personel të kualifikuar në vijimësi, tregon aftësi të larta profesionale dhe mundësi të mira për organizimin e punës dhe zbatimin me sukses të kontratave që do të lidhen gjatë zbatimit të MK.

Kriteri sipas pikës 2.3.3. “f”, të kapacitetit teknik, ku kërkohet që punonjësit të jenë pjesë e shoqërisë për një periudhë tre mujore, vlerësohet në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe në funksion të përzgjedhjes së OE që zotërojnë aftësinë teknike dhe profesionale për zbatimin e kontratës.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës :

Nr	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Makineri pusonatrice me kontroll numerik per prodhimin e profileve L nga 30x30x3 deri ne 150x150x15 per elementet e shtyllave	1(nje) cop ë	Pronësi ose me qera
2	Kamion transportues vete shkarkues me Vinc mbi 2.5 Ton	1(nje) cop ë	Pronësi ose me qera
3	Eskavator (skrep) me goma	1(nje) cop ë	Pronësi ose me qera
4	Motoarganello	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
5	Makineri terheqje percj.,tros, opgw mbi ≥ 35 kN	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
6	Makineri leshuese (frenuese) percj.,tros, opgw mbi ≥ 35 kN	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
7	Falkone	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
8	Set veglash per kablllo, (Motoperse Hidraulike ≥ 120 Ton)	1 (nje) sete	Pronësi ose me qera
9	Vibrator betoni	1(nje) copë	Pronësi ose me qera

10	Betoniere kantieri	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
11	Elektrosaldatriçe	1(nje) copë	Pronësi ose me qera
12	Matrapik	1(nje) copë	Pronësi ose me qera

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);*
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);*
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);*
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.*

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;*
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);*
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
- e) leje transporti nga njësia vendore (sipas rastit);*
- f) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.*

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi (2.3.4)

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë

me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Mjetet dhe pajisjet si më sipër kërkohen referuar zerave të preventivit të punimeve.

Konkretisht mjetet dhe pajisjet e kërkuara, janë si më poshtë :

- **Makineri pusonatrice** është kërkuar për prodhimin/pershtatjen e profileve të elementeve të shtylles, sipas permasave perkatese të shtylles së projektuar dhe datjeve shtese që mund të lindin gjatë punimeve.
- **Motoarganello** Përdorimi i **1 (një) motoarganelloje** është i domosdoshëm për realizimin e sigurt, efikas dhe në përputhje me kërkesat teknike të punimeve që parashikohen në objektin e kontratës. Nevoja për këtë pajisje argumentohet teknikisht si më poshtë:
- **Ngritjen, uljen dhe zhvendosjen e kontrolluar të pajisjeve dhe materialeve me peshë**, të cilat nuk mund të trajtohen manualisht pa rrezikuar sigurinë e punonjësve dhe integritetin e pajisjeve.
- **Punime në ambiente teknike dhe të kufizuara**, si nënstacione, panele, kanale kablllore apo struktura ekzistuese, ku përdorimi i mjeteve të rënda ngritëse nuk është i mundur ose praktik.
- **Rritjen e sigurisë në punë**, duke minimizuar rrezikun e dëmtimeve fizike dhe aksidenteve gjatë manipulimit të ngarkesave.
- **Saktësi dhe kontroll gjatë montimit**, veçanërisht për pozicionimin e pajisjeve elektrike dhe teknologjike që kërkojnë vendosje precize sipas projekteve të zbatimit.
- **Eficiencë dhe respektim të afateve**, pasi përdorimi i motoarganellos përshpejton procesin e montimit dhe redukton kohën e ndërhyrjes në terren.

Përfshirja e **1 (një) motoarganelloje** është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara, nuk përbën kriter kufizues për konkurrencën dhe garanton realizimin e kontratës në kushte optimale sigurie, cilësie dhe efikasiteti.

- **Makineri për tërheqjen e përcjellësve, trosit dhe OPGW mbi 150 kN**

Përdorimi i **1 (një) makinerie për tërheqjen e përcjellësve, trosit dhe OPGW me kapacitet mbi 150 kN** është i domosdoshëm për realizimin e sigurt, teknikisht korrekt dhe në përputhje me standardet e punimeve që parashikohen në objektin e kontratës. Kjo nevojë argumentohet si më poshtë:

- **Sigurimin e forcës së kontrolluar të tërheqjes**, e cila është e domosdoshme për instalimin e përcjellësve, trosit dhe OPGW pa i dëmtuar ata dhe pa tejkaluar limitet e lejuara mekanike të përcaktuara nga prodhuesit dhe standardet teknike.

- **Punime në linja ajrore të tensionit të lartë**, ku përdorimi i pajisjeve manuale ose makinerive me kapacitet më të ulët është teknikisht i papërshtatshëm dhe paraqet rrezik për sigurinë dhe cilësinë e punimeve.
- **Ruajtjen e integritetit të përcjellësve dhe fibrave optike (OPGW)**, të cilat kërkojnë kontroll të saktë të tensionit gjatë shtrirjes për të shmangur dëmtime strukturore, mikroçarje apo humbje të funksionalitetit.
- **Rritjen e sigurisë në punë**, duke reduktuar ndërhyrjet manuale dhe rrezikun e aksidenteve gjatë procesit të tërheqjes dhe shtrirjes së linjave.
- **Eficiencë dhe respektim të afateve kontraktuale**, pasi makineria me kapacitet mbi 150 kN mundëson realizimin e punimeve në segmente të gjata dhe në kushte të vështira terreni pa ndërprerje të shpeshta.

Përfshirja e **makinerisë për tërheqjen e përcjellësve, trosit dhe OPGW mbi 150 kN** është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara, nuk krijon kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe garanton cilësi, siguri dhe realizim të suksesshëm të kontratës.

- **Makineri lëshuese (frenuese) për përcjellës, tros dhe OPGW mbi 120 kN**

(për lëshimin ose tërheqjen e 4 përcjellësve njëkohësisht) – 1 (një) copë**

Përdorimi i **1 (një) makinerie lëshuese (frenuese) me kapacitet mbi 120 kN**, e aftë për lëshimin ose tërheqjen e 4 përcjellësve njëkohësisht, është i domosdoshëm për realizimin teknikisht korrekt, të sigurt dhe efikas të punimeve në linjat ajrore të energjisë elektrike. Kjo kërkesë argumentohet si më poshtë:

- **Kontrollin e saktë të tensionit dhe shpejtësisë gjatë lëshimit dhe tërheqjes** së përcjellësve, trosit dhe OPGW, duke garantuar respektimin e kufijve mekanikë të lejuar dhe standardeve teknike të prodhuesve.
- **Punime me shumë përcjellës paralelë**, ku lëshimi ose tërheqja e 4 përcjellësve njëkohësisht siguron uniformitet të tensionit, pozicionim korrekt dhe shmang deformimet apo ngarkesat e pabarabarta në linjë.
- **Ruajtjen e integritetit të përcjellësve dhe fibrave optike (OPGW)**, të cilat janë elementë të ndjeshëm ndaj mbingarkesave mekanike dhe kërkojnë pajisje frenuese të certifikuara.
- **Rritjen e sigurisë në punë**, duke reduktuar ndërhyrjet manuale dhe rrezikun e aksidenteve gjatë fazave kritike të shtrirjes dhe montimit të linjës.
- **Rritjen e efikasitetit dhe respektimin e afateve kontraktuale**, pasi përdorimi i kësaj makinerie mundëson realizimin e segmenteve të gjata të linjës në kohë më të shkurtër dhe me cilësi të garantuar.

Përfshirja e **makinerisë lëshuese (frenuese) për përcjellës, tros dhe OPGW mbi ≥ 35 kN**, është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara, nuk përbën kriter kufizues për konkurrencën dhe garanton realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet e sigurisë.

- **Falkone.**

Përdorimi i **1 (një) pajisjeje Falkone**, është i domosdoshëm për realizimin teknikisht korrekt, të sigurt dhe efikas të punimeve në linjat ajrore të energjisë elektrike. Kjo kërkesë argumentohet si më poshtë:

- **Kalimin e litarëve pilot dhe përcjellësve mbi distanca të gjata dhe pengesa natyrore apo artificiale**, si lugina, rrugë, ndërtesa dhe objekte ekzistuese, ku metodat tradicionale janë të pamjaftueshme ose të pasigurta.
- **Reduktimin e ndërhyrjeve në terren dhe minimizimin e rrezikut**, pasi përdorimi i Falkone-s shmang nevojën për kalime manuale ose përdorimin e mjeteve të rënda në zona të vështira.
- **Rritjen e sigurisë në punë**, duke ulur ndjeshëm ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve gjatë shtrirjes fillestare të linjës.
- **Saktësi dhe kontroll në fazën paraprake të shtrirjes së linjës**, duke garantuar pozicionim korrekt të litarëve pilot, që është thelbësor për tërheqjen e mëvonshme të përcjellësve dhe OPGW.

- **Eficiencë dhe respektim të afateve kontraktuale**, pasi përdorimi i kësaj pajisjeje përshejton ndjeshëm procesin e instalimit të linjave ajrore.

Përfshirja e **1 (një) Falkone**, në **pronësi ose me qira**, është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara, nuk krijon kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë dhe garanton realizimin e kontratës në përputhje me kërkesat teknike dhe standardet e sigurisë.

- **Set veglash për kablo**

(Motopresë hidraulike ≥ 120 ton) – 1 (një) set**

Përdorimi i **1 (një) seti veglash për kablo**, i pajisur me **motopresë hidraulike me kapacitet minimal ≥ 120 ton**, është i domosdoshëm për realizimin teknikisht korrekt, të sigurt dhe në përputhje me standardet e punimeve që parashikohen në objektin e kontratës. Kjo kërkesë argumentohet si më poshtë:

- **Realizimin e presimit profesional të lidhjeve të kablllove**, përfshirë bashkuesit, terminalët dhe aksesorët përkatës, duke garantuar kontakt elektrik optimal dhe rezistencë mekanike të qëndrueshme.
- **Sigurimin e forcës së nevojshme të presimit**, veçanërisht për kablo me seksione të mëdha dhe aplikime në sisteme të tensionit të lartë, ku pajisjet me kapacitet më të ulët nuk ofrojnë presim të sigurt dhe të certifikuar.
- **Parandalimin e defekteve elektrike dhe termike**, si mbinxehja, rënia e tensionit apo shkëputja e lidhjeve, të cilat mund të lindin nga presimi jo i saktë ose jo i njëtrajtshëm.
- **Rritjen e sigurisë në punë**, duke minimizuar ndërhyrjet manuale dhe rrezikun e aksidenteve gjatë procesit të montimit të kablllove.
- **Respektimin e standardeve teknike dhe rekomandimeve të prodhuesve**, të cilat parashikojnë përdorimin e presave hidraulike me kapacitet të lartë për këtë kategori punimesh.

Përfshirja e **setit të veglave për kablo me motopresë hidraulike ≥ 120 ton** është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara, nuk përbën kriter kufizues për konkurrencën dhe garanton cilësi, siguri dhe funksionim afatgjatë të instalimeve elektrike.

- Kamionat vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton dhe kamionçinat me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton, janë kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (Transport dheu dhe mbeturinash me auto deri në 10km).
- Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton është kërkuar për nevoja transporti të materialeve të ndryshme.
- Eskavator (skrep) me goma, kjo makinieri është kërkuar për natyrën e punimeve në ndërtimin e shtyllave TL, hapje germim dheu në toke me fortesi të ndryshme, dhe sipas zërave që janë në preventivin njësi të punimeve të kërkuara.
- Elektrosaldatriçe është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (saldime të ndryshme profilesh metalike, ele dhe llamarine).
- Vibrator betoni është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve.
- Matrapik është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve.
- Betoniere kantieri është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve.

-
- Tranxhe për perpunimin e hekurit te ndertimit është kërkuar në funksion të realizimit të zërave të punës, referuar preventivit të punimeve si (F.V. hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm dhe F.V. hekur betoni periodik Ø > 12 mm, etj).

2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, të mjedisit dhe se proceset e saldimit realizohen sipas standardeve më të larta teknike. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Certifikatë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit te cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001 - 2018 SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001 – 2023)** ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do te paraqese ISO-t në baze te zerave te punimeve qe ka marre persiper te realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI** mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit.

Për vet natyrën e veçantë, rëndësinë, vendndodhjen dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

ISO 9001: është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001: me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001: është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001- me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur

mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 14001: ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001: me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim 1 :

Ofertuesit kanë detyrimin që të hartojnë ofertat e tyre në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, përfshirë këtu edhe preventivin, i cili duhet të përgatitet sipas parashikimeve të :

- nenit 29 të Rr.P.P., miratuar me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.
- dokumenteve të tenderit, Seksioni I - Udhëzime për operatorët ekonomikë, B - Përgatitja e ofertave, pika 6, nënpikat 3 & 4, ku përcaktohet se:

- Të gjitha çmimet duhet të kuotohen në Monedhën sipas Njoftimit të Kontratës, duke përfshirë edhe tatimet dhe taksat që zbatohen, pa përfshirë TVSH-në.

- Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet njësi të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës.

Mos respektimi këtyre kërkesave do të konsiderohet si devijimi/shmangie e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit dhe do të sjellë refuzimin e ofertës.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____**deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik
(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁵.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

⁵ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th.

bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
